

Znj. Ami Çarçani ka lindur më 13 korrik 1988. Aktualisht mban detyrën e Drejtoreshës së Përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Publike dhe Migracionit.

Ajo është profesioniste me përvojë të konsoliduar në menaxhimin financiar dhe koordinimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë, me ekspertizë të veçantë në programet IPA, menaxhimin e kontratave dhe zhvillimin e projekteve strategjike.

Znj. Çarçani ka ushtruar po ashtu funksionin e Pikës Kombëtare të Kontaktit për programet e Bashkimit Evropian, si “Creative Europe” dhe “Citizens, Equality, Rights and Values (CERV)”, duke përfaqësuar Shqipërinë dhe duke mbështetur aplikantët në zhvillimin dhe implementimin e projekteve.

Më herët, ajo ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Drejtorisë së Partneriteteve Strategjike, Diasporës dhe Migracionit në Bashkinë e Tiranës.

Gjatë karrierës së saj në administratën publike, znj. Çarçani ka ushtruar disa funksione drejtuese në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ajo ka qenë përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e projekteve, si dhe për garantimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të menaxhimit financiar dhe prokurimit.

Karrierën profesionale e ka nisur në fushën e menaxhimit financiar të projekteve dhe kontrollit financiar, duke kontribuar në administrimin dhe auditimin e fondeve ndërkombëtare. Gjithashtu, ka qenë e angazhuar në mësimdhënie si asistente profesore në Universitetin Politeknik të Tiranës në fushën e investimeve dhe tregjeve financiare.

Znj. Çarçani ka përfunduar studimet universitare dhe master në Financë në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Gjatë karrierës së saj ka ndjekur një sërë trajnimesh dhe programesh ndërkombëtare në fushën e menaxhimit financiar, prokurimit publik dhe menaxhimit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian.

Znj. Çarçani zotëron aftësi të avancuara në menaxhimin e projekteve, planifikimin strategjik, analizën financiare dhe koordinimin ndërinstitucional. Ajo flet gjuhën angleze në nivel shumë të mirë dhe ka njohuri të gjuhës italiane dhe spanjolle, krahas gjuhës amtare shqipe.